



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.47/2017

Prishtinë, më 8 shkurt 2017

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Nenad Rashed dhe Shukrije Bytyqi.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës, Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Florije Kryeziu-Unicef, Donjetë Kelmendi-KOMF, Lirije Lokaj-Terre Des Homes, Vebi Mujku-QPS Prishtinë dhe Ahmet Rushiti-KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj në vazhdim, Komisioni i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
2. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme

Kryetarja, konstatoi se procesverbali i mbledhjes se mbajtur me 24 janar 2017, u miratua pa vërejtje.

2.Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

Kryetarja, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, sqaroi anëtarët e Komisionit se për këtë mbledhje nuk kemi renditur pika të tjera për shqyrtim, në mënyrë që të punohet maksimalisht, në veçanti rreth amendamenteve të propozuara nga grupi punues, ashtu që sa më parë ta përfundojmë këtë Projektligj.

Ajo, në vazhdim fjalën ia dha deputetes Mexhide Mjaku-Topalli, kryesuese e Grupit punues që të bëjë prezantimin punës së bërë dhe të propozim-amendamenteve.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se grupi punues në përbërje: Mexhide Mjaku-Topalli, Hetem Arifi dhe Teuta Haxhiu, ka mbajtur 5 takime të rregullta ku përveç anëtareve të grupit punues, në takime të grupit herë pas here kanë marrë pjesë edhe anëtarët e tjerë të komisionit të cilët kanë dhënë kontributin e tyre.

Gjate shqyrtimit të Projektligjit, nen për nen, si grup punues, kemi marrë për bazë edhe propozimet e bëra në Punëtorinë në Durrës, si dhe komentet dhe propozimet e bëra nga organizatat që na kanë mbështetur në këtë Projektligj.

Ajo më pas prezantoi propozim-amendamentet e grupit punues për nenet që janë konsideruar se duhet amendamentuar, duke u ndalur ne propozimet një nga një si në vijim:

Propozim-amendamenti 1, ka të bëjë me heqjen e fjalës „Tradicionale”, në tërë tekstin e Projektligjit.

Propozim-amendament 2, ka të bëjë me zëvendësimin e fjalëve „Ndihmë ligjore” me fjalët „Ndihmë juridike”, në tërë tekstin e Projektligjit.

Propozim-amendamenti 3, ka të bëjë me nenin 1 paragrafi 1 pika 1.2.

Propozim-amendamenti 4, ka të bëjë me nenin 3, paragrafi 1, pika 1.5.

Propozim-amendamenti 5, ka të bëjë me nenin 3 pas paragrafit 1.6 shtohet një paragraf i ri 1.7, dhe radhitja e paragrafëve bëhet sipas numrave me radhë.

Paragrafët 1.7.1 dhe 1.7.2 fshihen.

Në nenin 3, paragrafi 1, pika 1.9, riformulohet titulli.

Në nenin 3, pika 1, paragrafi 1.12 riformulohet.

Në nenin 3, paragrafi 1, pika 1.15, në rreshtin e katërt dhe të pestë, fjalët “asistencës ligjore” zëvendësohen me fjalët “ndihmës juridike” dhe fjalia vazhdon si në projektligj.

Në pikën 1.22, në rreshtin e fundit fjala „keqzhvillim” zëvendësohet me fjalët „ngecje në zhvillim”.

Paragrafi 1.23 në rreshtin e katërt pas fjalëve “të fëmijës” pjesa tjetër e tekstit fshihet.

Neni 3 paragrafi 1.32.2 riformulohet.

Neni 3, Paragrafi 1.36.1 në rreshtin e pestë fjala “për” zëvendësohet me fjalën “në” dhe fjalia vazhdon si ne projektligj.

Neni 3, Paragrafi 1.37.1 fjala “cytje” fshihet.

Paragrafët 1.37.2 dhe 1.37.3 fshihen.

Neni 3, Paragrafi 1.38 fjalët “kur konteksti nuk e përcakton ndryshe,” fshihet dhe fjalia vazhdon si në projektligj.

Ne rreshtin e shtate fjalët “në kuptimet e përcaktuara” fshihen dhe fjalia vazhdon si në projektligj.

Neni 3, Paragrafi 1.40, në rreshtin e fundit fjala “të Drejtave “ fshihet.

Neni 3 paragrafi 1.42 riformulohet.

Në nenin 3, paragrafi 2 fshihet.

Propozim-amendamenti 6, ka të bëjë me nenin 4, paragrafi 1.

Propozim-amendament 7, Neni 5 riformulohet.

Propozim-amendamenti 8, ka të bëjë me titullin e nenit 7.

Paragrafi 1 i nenit 7 riformulohet.

Paragrafi 2 i nenit 7 riformulohet.

Propozim-amendamenti 9, ka të bëjë me neni 8 paragrafi 1 riformulohet.

Paragrafi 2 propozohet te fshihet.

Anëtarët e Komisionit debatuan lidhur me propozimin që në të ardhmen njëri nga zëvendësit e Avokatit të popullit të caktohet Zëvendës-Avokat për mbrojtjen e fëmijës. Për këtë u vendos të analizohet mundësia dhe të konsultohet edhe Avokati i Popullit, në mënyrë që mos te bie ndesh me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Komisioni shqyrtoi propozim-amendamentet deri te neni 8 i Projektligjit dhe u vendos që në mbledhjen e radhës të shqyrtohen propozime amendamentet e propozuara për nenet në vijim.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Lirije KAJTAZI